

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6880
E mërkurë, 26 prill 2023
Çmimi 0.40

KQZ-ja shpall
rezultatet e
zgjedhjeve në veri FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË MARTËN ËSHTË PUBLIKUAR NË GAZETËN ZYRTARE TË BE-SË RREGULLORJA 2023/850
E CILA MUNDËSON LIBERALIZIMIN E VIZAVE QYTETARËT E KOSOVËS FAQE 4-5

PËRMBYLLET I GJITHË PROCESI I LIBERALIZIMIT TË VIZAVE



Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën është botuar të martën në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Me këtë veprim përmbillet edhe formalisht

i gjithë procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Vendimi pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024 - prej kur qytetarët e Kosovës që kanë

pasaporta biometrike të lëshuara nga shteti i Kosovës, do të mund të udhëtojnë pa viza në atë që njihet si zona Schengen dhe përbëhet prej 27 shtetesh evropiane

**BERNARD KOUCHNER:
HASHIM THAÇI PUNOI
PËR TË ARDHMEN E TË
GJITHA KOMUNITETEVE,
UNË DËSHMOJ SE
AKUZAT NDAJ TIJ
JANË ABSURDE** FAQE 6



Reagim i KMDLNj-së

**A DO TË
KOMPENSOHEN
QYTETARËT E
KOSOVËS PËR
RRYMËN E
PASHPENZUAR?**

**KURTI: FUQIZIMI I GRAVE
NË BIZNES, FUQIZIM I EKONOMISË
NË PËRGJITHËSI** F. 8

SPORT



**OSMANI PËR LICENCIMIN E FFK-SË: PO
SHOYRTOHET DOSJA E RE E KLUBEVE,
S'DO TË KETË ASNJË LËSHIM** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni kërkon edhe një mandat presidencial

WASHINGTON, 25 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, njoftoi se do të garojë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2024. Ai këtë njoftim e bëri përmes një videoje promovuese. Në videon prej tre minutash, Bideni, presidenti i 46 i ShBA-së, tha se të drejtat e abortit, mbrojtja e demokracisë, të drejtat e votimit dhe siguria sociale do të jenë çështjet më kryesore gjatë garës presidenciale të vitit 2024.

Ai tha se votuesit do të përballen me zgjedhjen mes asaj nëse gjenerata e re do të ketë "më shumë apo më pak liri" dhe "më shumë apo më pak të drejta". "Çdo gjeneratë e amerikanëve është përballur me një moment kur janë dashur të mbrojnë demokracinë, të ngrihen për të drejtat e tyre personale, të ngrihen për të drejtat e votimit dhe të drejtat civile. Ky është momenti ynë", tha Biden. Për dallim nga slogani i fushatës zgjedhore të vitit 2020, kur Biden tha se amerikanët ishin "në betejë për shpirtin" e kombit, slogani për zgjedhjet e vitit 2024 thotë: "Le ta çojmë punën deri në fund".

Nëse rizgjidhet, Biden do të ishte 86-vjeçar në fund të mandatit të dytë presidencial. Ai pritet të përballlet me një garë të lehtë brenda partisë së tij, pasi nuk ka

rivalë seriozë në mesin e Partisë Demokratike. Megjithatë, ai ka një detyrë të vështirë për të vazhduar që të mbajë mandatin presidencial në një shtet të ndarë. "Liria, liria personale është thelbësore për ne amerikanët. Nuk ka asgjë më të rëndësishme, asgjë më të shenjtë", tha Biden në video-adresim.

Biden e përshkroi Partinë Republikane si "ekstremiste", që sipas tij po tenton të heqë qasjen në të drejtën për abort, në sigurinë sociale, të kufizojë të drejtat e votimit dhe të ndalojë librat me të cilët ata nuk pajtohen. "Në mbarë vendin, ekstremistët MAGA [mbështetësit e ish-presidentit amerikan, Donald Trump] janë rreshtuar për të na i hequr liritë", tha Biden.

Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, më herët ka shpallur kandidaturën e tij për garën presidenciale. Trump kishte humbur garën zgjedhore ndaj Bidenit më 2020.

Në dy vjetët e para të mandatit të tij presidencial, Biden u mor me luftimin e pandemisë së koronavirusit dhe shtyrjes përpara të legjislacioneve, sikurse ato të infrastrukturës dhe duke promovuar prodhimin e teknologjisë së lartë dhe vendosjen e masave për klimën.



Kush ka shpallur kandidaturën për president deri më tani?

Përveç Bidenit, në Partinë Demokratike deri më tani kandidaturën për zgjedhjet presidenciale të vitit 2024 e kanë shpallur edhe dy të tjerë. Marianne Williamson, shkrimtare, ka shpallur për herë të dytë garën për zgjedhjet presidenciale. Edhe demokrati tjetër, Robert F. Kennedy Jr. - nipi i ish-presidentit amerikan, John

F. Kennedy ka hyrë në garën presidenciale.

Në Partinë Republikane, përveç Trumpit, kandidaturën e kanë shpallur edhe tre politikanë të tjerë.

Nikki Haley, ish-guvernatore e Karolinës së Jugut dhe ambasadore e ShBA-së në OKB gjatë presidencës Trump, ka shpallur kandidaturën për zgjedhjet e vitit 2024.

Ngjashëm kanë vepruar edhe multimilioneri Vivek Ramaswamy dhe ish-guvernatori i Arkanasit, Asa Hutchinson.

Në Partinë Republikane pritet që garës për president t'i bashkohen edhe ish-nënpresidenti amerikan, Mike Pence, guvernatori i Floridës, Ron DeSantis, dhe senatori, Tim Scott.

Palët në Sudan pajtohen për një armëpushim treditor

KURTEM, 25 PRILL - Në mesnatë, në Sudan ka hyrë në fuqi një armëpushim 72 orësh. Kjo është hera e tretë që palët arrijnë marrëveshje për ndërprerjen e luftimeve që kur shpërtheu dhuna më herët gjatë këtij muaji, por marrëveshjet e mëhershme të armëpushimit janë shkelur.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se është arritur një marrëveshje midis ushtrisë dhe grupit paramilitar të Forcave të Mbështetjes së Shpejtë, pas 48 orësh negociata. Të paktën 400 persona janë vrarë që kur nisën luftimet më 15 prill. Të dyja palët e përfshira në konflikt kanë njoftuar ndarazi për marrëveshjen e armëpushimit.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka paralajmëruar se dhuna në Sudan rrezikon të shkaktojë një "zjarr shkatërrues" që do të mund të përfshinte të gjithë rajonin dhe më gjerë. Që kur ka nisur dhuna, banorët e kryeqytetit sudanez, Kartum, janë udhëzuar që të qëndrojnë në shtëpi, teksa ushqimet dhe furnizimet e tjera janë pakësuar. Bombardimet kanë goditur infrastrukturën kyçe, sikurse tubacionet e ujit, që nënkupton se disa persona janë detyruar që të përdorin ujin e lumit Nil për jipe.



Pas njoftimit për armëpushim është rritur shpresa se civilët do të mund të largohen nga kryeqyteti.

Qeveritë e huaja po ashtu shpresojnë se armëpushimi do të mundësojë vazhdimin e evakuimeve të shtetasve të tyre nga Sudani. Shtetet e huaja nxituan që të evakuonin diplomatët dhe civilët në kohën kur luftimet në kryeqytet u

intensifikuan.

Më herët gjatë 24 prillit, Blinken tha se disa autokolona po tentonin të largonin njerëz, por u përballën me grupe që po "grabisnin dhe plaçkitnin".

ShBA-ja, shtoi ai, po shikon mundësitë e një rikthimi të mundshëm të prezencën diplomatike në Sudan. Por, kryediplomati amerikan theksoi se kushtet ishin "shumë sfiduese".

Sudani po përballlet me ndërprerje të mëdha të internetit, thanë grupet monitoruese. Në Kartum, që nga mbrëmja e së dielës nuk ka qasje në internet.

Vlerësohet dhe dhjetëra mijëra persona, përfshirë edhe sudanezë dhe qytetarë nga shtetet fqinje, janë larguar nga shteti për shkak të trazirave. Dhuna shpërtheu fillimisht në kryeqytet, Kartum, midis

fraksioneve rivale ushtarake, që po luftojnë për kontrollin e Sudanit – shtetit të tretë më të madh në Afrikë.

Që nga grusht shteti i vitit 2021, Sudani është udhëhequr nga këshilli i gjeneralëve në krye me dy ushtarakët që aktualisht po luftojnë: gjenerali Abdel Fattah al-Burhan, që është kreu i forcave të armatosura dhe presidenti i shtetit, dhe zëvendësi i tij, gjenerali Mohamed Hamdan Dagalo, që udhëheq Forcat e Mbështetjes së Shpejtë.

Dy gjeneralët kanë mospajtime lidhur me mënyrën se si shteti do të shkojë drejt sundimit civil.

Mosmarrëveshjet kryesore në planin për trazicion kanë të bëjnë me përfshirjen e 100.000 anëtarëve të Forcave të Mbështetjes së Shpejtë në ushtrinë e rregullt, dhe se kush do të udhëheqë ushtrinë e re.

Gjenerali Dagalo e ka akuzuar Qeverinë e gjeneralit Burhan se përbëhet nga "islamikë radikalë" dhe se grupi i tij paraushtarak po "lufton për popullin e Sudanit dhe që të sigurojë përparim demokratik, të cilin qytetarët e duan për një kohë të gjatë".

Burhan ka thënë se mbështet idenë e rikthimit të sundimit civil, por ka shtuar se ai do t'ia dorëzojë pushtetin një qeverie që do të zgjidhet.

Ekonomia e Kosovës shfaq qëndrueshmëri pavarësisht ngadalësimit të rritjes

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 PRILL - Ekonomia e Shqipërisë, e Bosnjë-Hercegovinës, e Kosovës, e Malit të Zi, e Maqedonisë së Veriut dhe e Serbisë janë rritur duke tejkaluar nivelet e tyre para pandemisë pavarësisht prej pasojave nga pushtimi rus i Ukrainës, rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, kushteve të pafavorshme të motit, shtrëngimit të kushteve financiare dhe pasigurisë së konsiderueshme, thuhet në edicionin e fundit të raportit të rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, të publikuar të martën.

Perspektiva për Ballkanin Perëndimor mbetet e zbehtë, me rritjen e Bruto Prodhimit Vendor që pritet të ngadalësohet në 2.6 për qind në vitin 2023, e nxitur kryesisht nga konsumi privat, eksportet dhe, për disa vende, nga investimet publike, thuhet në raport.

Rajoni tani përballet me sfidat e rindërtimit të rezervave për t'u përgatitur për përballimin e goditjeve të ardhshme dhe realizimit të reformave në anën e ofertës që vendosin themelet për një rritje më të qëndrueshme dhe më të gjelbër, thuhet në raport. "Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë shfaqur qëndrueshmëri të jashtëzakonshme pavarësisht prej përballjes me pengesa të jashtëzakonshme ekonomike", ka thënë Xiaoqing Yu, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. Ajo ka theksuar se për ta vazhduar përballimin e tronditjeve të shkaktuara nga goditjet e shumëfishta ekonomike, vendet mund të përfitojnë shumë duke vazhduar zbatimin e reformave që nxisin produktivitetin në periudhë afatmesme, të tilla si përsheptimi

i integritit rajonal, rritja e nivelit të konkurrencës në treg, tërheqja e investimeve me cilësi më të lartë dhe lehtësimi i barrierave që kufizojnë pjesëmarrjen, veçanërisht të grave, në tregun e punës.

Në Kosovë në vitin 2022 u shënua një rritje më e lehtë ekonomike prej 3.5-përqindësh, e shtyrë nga eksportet dhe konsumi privat, i cili vazhdoi të tregojë qëndrueshmëri pavarësisht prej presioneve inflacioniste. Pozita fiskale vazhdoi të përmirësohej, udhëhequr nga performanca e vazhdueshme pozitive e të ardhurave publike kundrejt efekteve të inflacionit dhe përfitimeve nga rritja e formalizimit, si dhe nga nënshpenzimi i investimeve kapitale. Përgjatë 2023-s rritja e Bruto Prodhimit Vendor pritet të jetë pak më e lartë, duke arritur në 3.7 për qind. Megjithatë, rreziqet mbeten të larta. Presionet mund të rriten në rast të përshpejtimit të inflacionit dhe ngadalësimit të rritjes së ekonomive të BE-së përtej pritjeve të tanishme. "Në këtë kontekst është qenësore të ruhen rezerva të mjaftueshme për t'u përgjigjur ndryshimeve të papritura në mjedisin ekonomik", tha Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Ai ka theksuar se Banka Botërore në anën tjetër do të vazhdojë t'i mbështesë përpjekjet e Kosovës për ta bërë ekonominë e saj më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe për t'u ofruar qytetarëve të saj më shumë mundësi për një jetë më të mirë.

Inflacioni në Ballkanin Perëndimor u rrit ndjeshëm në vitin 2022 duke arritur në nivelin më të lartë të dy dekadave të fundit, dhe presionet në kahun e rritjes së çmimeve vijnë të jenë



të larta edhe në fillim të vitit 2023, thuhet në raport.

Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, inflacioni i çmimeve të konsumit arriti nivelin më të lartë nga fundi i vitit 2022, i nxitur nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, ndërsa tani po shfaq shenja të uljes, ku faktorët e jashtëm nxitës po zbehen për shkak të ngadalësimit të rritjes së ekonomisë botërore. Megjithatë, presionet inflacioniste mbeten të larta.

Kjo rritje e çmimeve ka prekur veçanërisht familjet me të ardhura të ulëta. Shoqëruar me një rritje më të dobët ekonomike, presioni nga çmimet e larta

rezultoi në një ritëm shumë më të ngadalë të uljes së varfërisë, pavarësisht prej disa përfitimeve të mundësuar nga programet mbështetëse të qeverive për t'i zburuar efektet e krizës energetike. Sipas raportit, faktorë të mundshëm me efekt kufizues në periudhat në vijim përfshijnë uljen e kërkesës së jashtme, e cila mund të ndikojë negativisht në të ardhurat nga eksportet dhe t'i reduktojë remitancat dhe ngushtimin e hapësirës fiskale, e cila vazhdon ta kufizojë mbështetjen që mund t'u ofrohet familjeve.

Pavarësisht prej rritjes së punësimit, ritmi i krijimit të vendeve të reja të punës u

ngadalësua në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në gjysmën e dytë të vitit 2022, thuhet në raport. Punësimi u tkurr më së shumti në sektorin e bujqësisë dhe në administratën publike, ndërkohë që në sektorin e industrisë dhe atë të shërbimeve u vu re një ngadalësim i rritjes së punësimit. Shkalla e punësimit arriti një rekord të lartë historik prej 47-përqindësh në shtator 2022, ndërsa më pas filloi të bjerë. Perspektiva afatmesme për Ballkanin Perëndimor mbetet pozitive, megjithëse është i nevojshëm zbatimi i reformave për ta përshpejtuar tranzicionin e gjelbër dhe për t'i adresuar sfidat kryesore strukturore.

KQZ-ja shpall rezultatet e zgjedhjeve në veri

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 PRILL - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatet për zgjedhjet lokale të 23 prillit që janë mbajtur në katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Sipas KQZ-së, në garën për kryetarin e ri të komunës të Leposaviqit, fitues është shpallur Lulzim Hetimi nga Lëvizja Vetëvendosje me 73.5 për qind të votave të fituara. Kjo parti fitoi garën edhe në Mitrovicë të Veriut. Kreu i ri i kësaj komune do të jetë Erden Atiq, që ka fituar 66.9 për qind të votave.

Dy komuna i kanë fituar kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës. Komunën e Zveçanit do ta udhëheqë Ilir Peci nga kjo



parti me 59 për qind të votave të fituara. Ndërkaq, në Zubin Potok fitues u shpall Izmir Zeqiri me 52.2 për qind të votave.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarët e rinj të katër komunave veriore u bojkotuan

gjerësisht nga popullata serbe atje. Sipas të dhënave të KQZ-së, në zgjedhje dolën 1 567 votues apo 3.47 për qind e trupit zgjedhor.

Më 23 prill u mbajtën edhe zgjedhjet e parakohshme për

asambletë komunale në Leposaviq dhe Zveçan.

Në Leposaviq Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 15 ulëse, Partia Demokratike e Kosovës dy, aq sa ka fituar edhe Partia e Serbëve të Kosovës.

Në Zveçan 11 ulëse në Asambleenë komunale i ka fituar Partia Demokratike e Kosovës, ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje tetë.

Në zgjedhjet e 23 prillit nuk mori pjesë Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë - që deri më tani kishte udhëhequr këto komuna. Kjo parti, që ka mbështetjen e Beogradit, bëri thirrje për bojkotim të procesit zgjedhor. Procesi zgjedhor kaloi pa asnjë incident dhe qytetarët, përveçse në disa shkolla, votuan edhe në 13 kontejnerë të

vendosur në lokacione të ndryshme në veri.

Komuniteti ndërkombëtar ka shprehur keqardhjen për mospjesëmarrjen e partive serbe në këto zgjedhje, pasi vetëm një kandidat e pavarur serbe garoi për kreun e Zveçanit.

Autoritetet në Prishtinë kanë thënë se banorët në veri kanë qenë cak i "frikësimit dhe shantazhit" nga grupet që "mbështeten nga Beogradi" për të mos marrë pjesë në zgjedhje. Komunat në veri mbetën pa kryetarë nga nëntori i vitit të kaluar, kur përfaqësuesit serbë në atë zonë dhanë dorëheqje nga vendet e tyre të punës për shkak të mospajtitimit me një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe.



TË MARTËN ËSHTË PUBLIKUAR NË GAZETËN ZYRTARE TË BE-SË RREGULLORJA 2023/850 E CILA MUNDËSON LIBERALIZIMIN E VIZAVE QYTETARËT E KOSOVËS

Përmbyllet i gjithë procesi i liberalizimit të vizave

Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën është botuar të martën në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Me këtë veprim përmbyllet edhe formalisht i gjithë procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Vendimi pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024 - prej kur qytetarët e Kosovës që kanë pasaporta biometrike të lëshuara nga shteti i Kosovës, do të mund të udhëtojnë pa viza në atë që njihet si zona Schengen dhe përbëhet prej 27 shtetesh evropiane

PRISHINË, 25 MAJ - Vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën është botuar të martën në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Me këtë veprim përmbyllet edhe formalisht i gjithë procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Vendimi pritet të hyjë në fuqi më 1 janar të vitit 2024 - prej kur qytetarët e Kosovës që kanë pasaporta biometrike të lëshuara nga shteti i Kosovës, do të mund të udhëtojnë pa viza në atë që njihet si zona Schengen dhe përbëhet prej 27 shtetesh evropiane. Vendimi i botuar në Gazetën Zyrtare të BE-së është ai që është nënshkruar më 19 prill nga përfaqësuesit e Parlamentit Evropian dhe ata të Këshillit të BE-

së. Në vendim shkruan se "përfundimi nga nevoja për viza", pra liberalizimi, nuk mund të zbatohet para nisjes operacionale të sistemit të udhëtimit në Evropë

- ETIAS, apo deri më 1 janar 2024. Kjo do të thotë se, nëse funksionalizimi i ETIAS-it shtyhet përtej 1 janarit 2024 - gjë që edhe pritet të ndodhë - hyrja në fuqi e liberalizimit nuk do të shtyhet përtej asaj date.

ETIAS do ta mundësojë verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta - që nuk kanë nevojë për vizë - përpara se të hyjnë në zonën Schengen. Liberalizimi i vizave mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga shtetet anëtare të zonës Schengen.

Udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe në asnjë rast nuk nënkuptojnë leje pune ose

Sa para shpenzuan kosovarët në aplikime për viza?

Sipas të dhënave të Grupit për Ballkan, kosovarët shpenzojnë mesatarisht 165 euro për aplikim për vizë Schengen. Kur kjo vlerë i shtohet numrit të aplikimeve, del që kosovarët kanë shpenzuar mbi 72 milionë euro gjatë viteve 2016-2021.

Shasha: Institucionet e Kosovës kanë kohë të mjaftueshëm të ndërmarrin fushatat e nevojshme për informimin e qytetarëve

Drejtori i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka theksuar se rregullorja e publikuar të martën në gazetën zyrtare të BE-së mundëson liberalizimin e vizave për Kosovën. Ai ka njoftuar se sipas nenit 2 të Rregullores ajo hyn në fuqi më 15 maj 2023. "Kjo do t'u lejojë mjaftueshëm kohë institucioneve të Kosovës t'i ndërmarrin fushatat e nevojshme të informimit për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve që burojnë nga lëvizja e lirë në Zonën Schengen, por edhe do t'u japë mjaftueshëm kohë autoriteteve kufitare të vendeve të BE-së të përgatiten për lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës nga 1 janar 2024", ka theksuar Shasha.

përfitime të tjera.

Komisioni Evropian ka sqaruar tashmë se edhe pas liberalizimit të vizave, bartësit e pasaportave të Kosovës nuk do të mund të udhëtojnë në Spanjë - vend që nuk e njih as pavarësinë e Kosovës, as pasaportat e saj. Edhe pse vendimi për liberalizim vlen për të gjitha vendet e Schengenit, njohja e pasaportave është kompetencë e vendeve anëtare - në këtë rast Spanjë. Komisioni Evropian ka sqaruar, po ashtu, se liberalizimi i vizave vlen vetëm për poseduesit e

pasaportës së Kosovës, por jo edhe për ata shtetas të Kosovës që kanë pasaporta të lëshuara nga autoritetet serbe.

Kosova mbetet vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin ende lirshëm në zonën Schengen, me gjithë faktin se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbytur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezervë. /Rel

Rasti i liderëve të UÇK-së, në muajin maj mbahen dhjetë seanca gjyqësore

HAGË, 25 PRILL - Procesi gjyqësor ndaj katër drejtuesve të UÇK-së në Hagë ka filluar më 3 prill të këtij viti. Gjatë këtij muaji janë paraqitur fjalët hyrëse të prokurorisë dhe mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Po në këtë muaj janë dëgjuar edhe dy dëshmitarë të prokurorisë të cilët kanë dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun. Sipas kalendarit të Gjykatës Speciale, gjatë muajit maj janë paraparë të mbahen dhjetë seanca gjyqësore. Seancat gjyqësore ku do të dëgjoen dëshmitarët e prokurorisë

pritet të mbahen më 10, 11, 12, 15, 16, 17, 18, 22, 23 dhe 24 maj.

Në fjalët hyrëse, mbrojtja e katër liderëve të UÇK-së ka hedhur poshtë të gjitha akuzat ndaj klientëve të tyre me të cilat është duke i ngarkuar prokuroria.

Edhe liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë hedhur poshtë të gjitha pretendimet e prokurorisë, kurse në emër të Kadri Veselit ka folur vetëm avokati i tij, Ben Emmerson.

Katërshja e UÇK-së gjendet në paraburgim në Hagë që nga fillimi i nëntorit të vitit 2020.



Komisioni i Granteve: Buxheti komunal për vitin 2024 kap vlerën 742 milionë euro



PRISHTINË, 25 PRILL - Nën udhëheqjen e kryeministrit Albin Kurti është mbajtur të martën takimi i Komisionit të Granteve, ku u diskutua dhe u aprovua financimi komunal për vitin 2024-2026.

Drafti i përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për financimin komunal për periudhën 2024-2026 është i bazuar në legjislacionin për financat publike dhe aprovimi i këtij drafti do t'u mundësojë komunave dhe nivelit qendror zhvillimin e rregullt të procesit

buxhetor.

Në total, buxheti komunal për vitin 2024 në nivelin komunal kap vlerën prej 742.02 milionë euro, e që paraqet një rritje prej 82.51 milionë euro krahasuar me buxhetin komunal të vitit 2023.

Granti i përgjithshëm për vitin 2024 kap shumën prej 284.68 milionë euro, e që paraqet vlerën më të madhe ndonjëherë për këtë grant. Kjo vlerë rekord e grantit të përgjithshëm vjen si rezultat i drejtpërdrejtë të rritjes së të hyrave në buxhetin e shtetit. Rritje ka edhe

në grantin specifik për Shëndetësi dhe grantin specifik për arsimin. Granti për shëndetësi për vitin 2024 ka rritje prej 16 për qind krahasuar me vitin 2023, apo 11.5 milionë euro, ndërsa granti për arsimin është rritur për 18.5 për qind, apo 37 milionë euro.

Komisioni i Granteve ka miratuar buxhetin me rritje edhe për grantin e kryeqytetit me afro 12 për qind krahasuar me vitin 2023, si dhe financimin për teatrot me rritje prej 80 për qind apo 720 mijë euro.

Haradinaj në Sallagrazhdë të Suharekës: Fadil Vata ishte intelektual dhe patriot i pathyeshëm

SUHAREKË, 25 PRILL - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, së bashku me bashkëpunëtorë, në Sallagrazhdë të Suharekës, ka nderuar dhe kujtuar sakrificën sublime për lirinë e atdheut të njërit prej veprimtarëve më të shquar të lëvizjes sonë kombëtare - heroit të kombit Fadil Vata. "Fadili ishte intelektual dhe patriot i pathyeshëm. Pas daljes nga

burgu e deri në ditët e fundit të jetës, ishte shtyllë e lëvizjes patriotike - mishërim i idealeve për fitore, frymëzim për kryengritjen që po vinte, ku trimat e UÇK-së zhvilluan betejat që e larguan përgjithmonë pushtuesin. Është frymëzuese sakrificat e tij në shërbim të atdheut. Ashtu mbetet edhe sot, frymëzim për ata që çmojnë frytet e lirisë", ka theksuar Haradinaj.



Arrestimi i drejtorit të KEK-ut, opozita mblodhi nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 25 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se kanë mbledhur 40 nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme për të mërkurën në orën 11:00.

Në këtë seancë të jashtëzakonshme Tahiri thotë se opozita do të kërkojë përgjegjësi për aktualitetin në Kosovë për

rastin e arrestimit të Nagip Krasniqit, drejtorit të KEK-ut. "Sapo dorëzova kërkesën e mbështetur nga 40 deputetë për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit për nesër nga ora 11:00, ku do të kërkojmë përgjegjësi për aktualitetin e krijuar me rastin e arrestimit për korrupsion të zyrtarit të lartë të Lëvizjes Vetëvendosje, i

emëruar nga pushteti në krye të KEK-ut", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur 30 ditë paraburgim për Krasniqin, i cili po dyshohet për tri vepra penale.

Krasniqi dyshohet për "keqpërdorim të detyrës zyrtare", "ushtrim të ndikimit" dhe "konflikt i interesit".

Bernard Kouchner: Hashim Thaçi punoi për të ardhmen e të gjitha komuniteteve, unë dëshmoj se akuzat ndaj tij janë absurde



“Hashim Thaçi ishte njeri i tolerancës dhe i pajtimit mes komuniteteve dhe edhe sot është lider i pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. A është kjo arseja që disa duan për ta njollosur duke bërë akuzat kundër tij si ato që përmban raporti i Martit? Është e mundur. Unë vetë e di, sepse kam qenë atje, që ato akuzat janë aq imagjinatë fantazuese, ato janë absurde. Unë mund të dëshmoj për këtë”, ka shkruar shefi i parë i UNMIK-ut në Kosovë, Bernard Kouchner.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dje mbushi 55 vjet, por më shumë se gjysmën e jetës e kaloi në angazhim për çlirim të vendit, pavarësinë dhe të ardhmen për të gjitha komunitetet, pa dallim etnie.

Pas një karriere të bujshme politike gjatë tri dekadave të fundit, ai ndodhet sot në Hagë, në Gjykatën Speciale dhe është deklaruar i pafajshëm për të gjitha akuzat që prokuroria i ka ngritur ndaj tij. Më poshtë e gjeni shkrimin e ish-ministrit të Jashtëm francez, Bernard Kouchner, i cili punoi ngushtë me Hashim Thaçin, në muajt dhe vitet e para pas luftës, dhe shkruan për angazhimin e tyre në rindërtimin e vendit, ndërtimin e institucioneve të para, për paqe, tolerancë dhe pajtim mes të gjitha komuniteteve etnike.

Shkrimi është botuar në librin “Lindja e një demokracie: Hashim Thaçi dhe rruga drejt pavarësisë së Kosovës nga Jacques Baudouin”, në frëngjisht, në vitin 2018.

Disa vende lënë gjurmë të pashlyeshme te ju. Unë kam njohur dhe vizituar një numër të

madh të tyre, shpesh në kushte të rrezikshme, por pak prej tyre kanë lënë një përshtypje kaq të fortë si ky cep i vogël i Ballkanit, Kosova, i rrethuar me male madhështore. Manastiret ortodokse qëndrojnë pranë xhamive që datojnë që nga Perandoria Osmane dhe kishat e lashta katolike; ku banorët janë të larmishëm dhe hezitojnë të ngrohen deri sa të vendoset besimi.

Mos vallë sepse u çlirua falë aplikimit të OKB-së të së drejtës së ndërhyrja humanitare, e cila është kthyer në “përgjegjësi për të mbrojtur” në gjuhën e OKB-së, ose sepse unë ushtroja aty përgjegjësitë që më besonte Sekretari i Përgjithshëm në atë kohë, Kofi Anan? Ndoshta sepse krimet dhe masakrat ngadalë hapën rrugën drejt paqes. “Nuk kam qenë kurrë më i lumtur se në Kosovë”, kam shkruar në “Les Guerriers de la paix” në vitin 2004. Ishte sepse u ndjeva i dobishëm atje, “nga dy bindje që janë vetëm një: humanitarizmi dhe politika. Dhe kur, dhjetë vjet më parë, Kosova u bë e pavarur dhe se pavarësia u njoh nga shumica e vendeve të botës, me përjashtim i dukshëm i Rusisë, mendova se ne – ketu i kam parasysh: Kofi Annan, Bill Clinton, Richard Holbrooke, Madeleine Albright, Jacques Chirac, Tony Blair, Lionel Jospin, Robin Cook, Joschka Fischer por edhe ekipi i mrekullueshëm i UNMIK-ut - kishte qenë përgjegjës dhe i vendosur.

Për këtë pavarësi, kulm i viteve të luftës, negociatave dhe vendosmërisë nga ana e liderit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi dhe liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ibrahim

Rugova, Kosova pagoi shumë çmim.

Kur arrita në Prishtinë në korrik 1999 në krye të UNMIK-ut, vendi që lindi nga plagët e luftës së pamëshirshme që trupat serbe kishin zhvilluar kundër UÇK-së popullatës shqiptare ende vuante nga abuzimet e kryera nga militantet serbë: fshatra të tërë në gjermadha, shtet dhe administratë inekzistente, pa shërbime publike, varfëri e përgjithshme që bëhet më mizore nga mungesa e nevojave elementare, ujë të pijshëm dhe shpeshherë të energjisë elektrike. Pas vite luftimi kundër çmendurisë shkatërruese të Slobodan Millosheviqit, spastrimit etnik në shkallë të gjerë që kishte urdhëruar, 10.000 të vdekurit dhe të zhdukurit e shkakuar nga trupat serbe dhe paraushtarakëve, vendi duhej të rindërtohej plotësisht. Duhej të fillonte nga e para. I ballafaquar me dhimbjen e familjeve të ndjera, ne e dinim, burrat dhe gratë e UNMIK-ut dhe unë, se nuk kishim të drejtë të dështonim. Kosova ishte e lirë, por e mavijosur deri në thellësi të saj.

Përtej rindërtimit të vendit, kishte një tjetër, njerëzore, që ishte një prioritet absolut: kishim nevojë të pajtonim dy komunitetet që urrenin njëri-tjetrin, shqiptarët dhe serbët. Të dyja palët e shihnin të ardhmen me dyshim, ishin të mbushur me një historik të ndjenjave e pakënaqësisë së vazhdueshme. Shqiptarët, të cilët përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë, ishte keqtrajtuar për dekada nga kjo e fundit dhe ne mund ta kuptonim se donin të hakmerreshin. Vetë serbët që kanë banuar dhe ende jetojnë, veriu i Kosovës, me të drejtë kishin frikë

se do mund të jenë viktimë e hakmarrjes. Të alarmuar për këto rreziqe, komuniteti ndërkombëtar nuk e fshehu shqetësimin e tij. Shpërthimet nacionaliste, urrejtja dhe tensionet kishin lënë gjurmë të pashlyeshme dhe kisha frikë se serbët mund të largoheshin masivisht nga Kosova. Kjo nuk ndodhi, edhe pse në muajt e parë pas luftës nuk kishte polici apo ligj në Kosovë. Disa zgjodhën të strehoheshin në Serbi për t'i shpëtuar represionit nga fqinjët e tyre shqiptarë por ato largime për në Serbi nuk ishin aspak rezultat i organizuar apo dhunë etnike nga UÇK-ja. Ushtria Çlirimtare ishte çmilitarizuar me sukses dhe, sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, ishte UNMIK-u dhe KFOR-i që morën administratën dhe sigurinë e vendit.

Për lehtësimin tim të madh, nuk pati eksod dhe shumica e familjeve serbe mbeten në tokën e të parëve të tyre. Ishte edhe dëshira dhe vullneti i Hashim Thaçit që ishte plotësisht i vetëdijshëm se vendi i tij së shpejti duhet të kënaqte aspiratat e të gjithë qytetarëve, duke përfshirë edhe serbët, për një Kosovë multi-etnike. Detyra e tij nuk ishte e lehtë fare, ai duhej të ruante besimin e luftëtarëve të UÇK-së në demokraci dhe flakën patriotike ndërsa punonte për të promovuar një Kosovë ku serbët do të ndjehen si qytetarë të barabartë. Ashtu si unë, ai e dinte se bashkëjetesa do të ishte e vështirë, se rikthimi i besimit mes dy komuniteteve, formimi i një Kosove multi-etnike do të kërkonte kohë, diplomaci, vullnet të mirë, madje edhe një aftësi të caktuar për të harruar nga të dyja anët. Unë dhe ai punuam dorë për dorë. Dhe ai nuk kurseu

asnjë përpjekje gjatë gjithë kohës, gjatë pranisë time atje për ta bërë Kosovën atdheun e të gjithëve, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike.

Ndër liderët e UÇK-së dhe të Kosovës, ishte Hashim Thaçi ai që kishte menduar se më së shumti për të ardhmen. Ai kishte farkëtuar një vizion të vendit që donte t'ua linte trashëgim fëmijëve. Pasi kishte shkuar në luftë, ai ishte në pozitën më të mirë për të bërë paqe. Ai ishte njeri i tolerancës dhe i pajtimit mes komuniteteve dhe besoj se është edhe sot lideri i pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. A është kjo arseja që disa duan për ta njollosur duke bërë akuzat kundër tij si ato që përmban raporti i Martit? Është e mundur. Unë vetë e di, sepse kam qenë atje, që ato akuzat janë aq imagjinatë fantazuese, ato janë absurde. Unë mund të dëshmoj për këtë.

Po, Kosova e ka merituar të bëhet shtet sovran. Ishte një nga sukseset e rralla të komunitetit ndërkombëtar dhe një sukses i madh për Evropën. Dhe është mirë që në libër të rikthehet historia e ngjarjeve që çuan në këtë pavarësi. Ato u zhvilluan në fund të shekullit të kaluar, brenda një bote që ka pak të përbashkëta me atë të sotmen, një botë që ende kishte pika kthese të njohura dhe të pranuar nga të gjithë. Një botë e aftë të flasë me një zë kur gjërat themelore - paqja apo lufta - ishin në rrezik. Ajo kohë ka mbaruar. Aq më tepër arsye për të kujtuar se si disa burra dhe gra të vendosur, disa vende dhe organizata ndërkombëtare, të vetëdijshme për përgjegjësitë e tyre, ia dolën t'u jepnin fund masakrave të tmerrshme në tokën evropiane.

Ky libër na kujton gjithashtu se rruga drejt demokracisë është gjithmonë e gjatë dhe e vështirë. Se demokracia nuk arrihet kurrë pa sakrificë. Le të fitohet çdo ditë, si liderët politikë kosovarë dhe ata të vendeve që kanë vuajtur prej kohësh nga arbitrariteti dhe diktaturat. Me Hashim Thaçin, fillimisht kryeministër dhe tani president i Republikës, Kosova është në rrugën e zhvillimit të saj të ardhshëm brenda Evropës dhe Komunitetit Atlantik. Kosova aspiro, me Serbinë, të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Një shembull i shkëlqyer i përparimit dhe mirëkuptimit mes popujve se asgjë, shpresoj, nuk do t'i ndajë kurrë. Ajo nuk do të jetë e lehtë: duhet kohë që shpirtat e këqij të mos jenë shembuj për t'u ndjekur; duhet durim që bota të ndryshojë dhe të qetësohet vrulli i nacionalizmit.

Është marre nga libri “Lindja e një demokracie”: Hashim Thaçi dhe rruga drejt pavarësisë së Kosovës nga Jacques Baudouin, botimi në frëngjisht, në vitin 2018.

/Epoka e re/ S. Z.

Kryetarët e kontejnerëve!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Zgjedhjet e rregullta që nuk përfaqësojnë vullnetin e shumicës: Për katër komunat e veriut të Kosovës, më 23 prill 2023 u organizuan zgjedhjet lokale që paraprakisht, më kërkesë të ndërkombëtarëve ishin shtyrë për një kohë më të përshtatshme. Mendohej se me Marrëveshjen e Kapitullimit në Ohër e sidomos me aneksin për zbatim të kësaj marrëveshjeje do të rregullohej edhe çështja e zgjedhjeve lokale si dhe kthimi i serbëve në institucionet e Kosovës të cilat i kishin braktisur, jo shkak i ndonjë presioni por ekskluzivisht për shkaqe dhe nevoja politike! Serbët në Kosovë jetojnë më mirë se serbët në Serbi dhe, pa asnjë dyshim, serbët e Kosovës, përjashtuar një grupi të kriminalizuar, asnjëherë nuk do të trajtoheshin në Serbi siç trajtohen në Kosovë. Lista Serbe kishte kërkesa që asnjë shtet nuk do t'i realizon me dinamikën dhe qëllimet e vendosura; formimin e menjëhershëm të Zajebnicës dhe tërheqjen e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës. Po të pranoheshin këto kërkesa, ashtu si janë parashtruar do të nënkuptonte kapitullim të padiskutueshëm të shtetit. Një lojë, pa asnjë dyshim po luhet edhe me këto zgjedhje; ndërkombëtarët nuk po kundërshtojnë mbajtjen e tyre vetëm se po shprehin keqardhje për bojkotim të tyre nga Lista Serbe. Kanë menduar se ka serbë që do të marrin pjesë në zgjedhje duke luajtur në kartën e djegur të Jabllanoviqit i cili, në momentin e fundit dëshmoi se edhe ai gjen strehë dhe mrizon nën kapelën e Aleksandër Vuçiqit, i cili, aktualisht është padre padrino

(kryemafiozi) i Serbisë. Komisionari dhe vëzhguesi kryesor i procesit zgjedhor në veri të Kosovës, Xhelal Sfeqla ishte më i pranishëm para medieve se Papa Françesku në enciklikën urbi et orbi në Vatikan. Ka energji të jashtëzakonshme Xhelua sikur që nuk ka temë për të cilën nuk kishte përgjigje. Ma çfarë Kreshnik Radoniqi, Valmir Elezi, Valdete Daka apo Ismet Kryeziu!!!! Me kalimin apo më mirë të them rikthimin e Jabllanoviqit në kopenë që i takon, edhe vendvotimet u tkurrën bukur shumë. Në mungesë të objekteve ku më parë mbaheshin zgjedhjet (shkollat, kryesisht), u aktivizuan kontejnerët që përdoren vetëm në raste emergjente. Kishte parashikime se mund të ketë tensionim të situatës në mënyrë që të pengohen zgjedhjet e që nuk kishin ndonjë bazë aq më parë që padre padrino i Serbisë, Aleksandër Vuçiq nuk kishte asnjë interes për përshkallëzim të situatës në kohën kur bëri ftesë publike serbëve që të mos votojnë në këto zgjedhje të

organizuar nga Kurti, sipas tij, kryeministër i një shteti të rrejshëm, gjithashtu sipas tij. Pas kësaj edhe Jabllanoviqi ndërroi kapelën; në vend të një kapele euro- amerikane, në kokë e vendosi shajkaqen e Vuçiqit.

Si shkuan zgjedhjet: Mirë, pa asnjë problem, kishte votues aq sa kishte shikues në një seancë stërvitore të Llapit në Podujevë. Prej atyre që votuan, thuaja 99.99 për qind ishin shqiptarë, serbë nuk kishte fare apo kishte vetëm në gjurmë. Ishte një rast kur një kandidat për kryetarë (serbe) shoqërohej nga Njësia Speciale e Policisë së Kosovës, foto kjo që ishte e pranishme në disa agjenci mediatike botërore. Të marrin pjesë përmes votimit vetëm afërsisht 1500 votues, kjo nuk e besoj se të ketë ndodhur në ndonjë vend tjetër në botë! Të pohosh se këto janë zgjedhje legale dhe legjitime, me të cilat do ta gjeni një zgjidhje politike, është aq joserioze që nuk ia vlen të komentohet. Mos vallë kjo situatë i ngjanë asaj të qetësisë para furtunës! Mos vallë edhe kësaj radhe, padre padrino i

Serbisë, Aleksandër Vuçiq, bashkë me disa ndërkombëtarë na e hodhi paq! Mos vallë kryeministri Albin Kurti duke dëgjuar këshillat e atyre që babë e babëgjysh i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë ndërsa për veten e tyre të mos flasim, ia vendosi Kurtit skitë në një terren të rrëshqitshëm dhe i papërshtatshëm për ski me qëllim t'ia thyej kokën siç ua kishte thyer disave para KM, Albin Kurtit?! Mos është vallë kjo vetëm një lojë për të fshehur lëshimet e mëvonshme e që fillojnë më 2 maj 2023 kur edhe do të dorëzohet drafti i parë i Zajebnicës! Babai i autonomisë substanciale për Kosovën, ambasadori Hill edhe kur fletë për futbollin amerikan hyrjen e ka, para së gjithash dhe mbi të gjitha formimin e menjëhershëm të Zajebnicës. Mbase edhe kjo ka ndikuar që të ketë qetësi, por jo edhe qartësi, në këto zgjedhje lokale, deri në themelimin e Zajebnicës kur edhe fillon një periudhë e re për Kosovën. Mos mendoni rastësisht se këta që i fituan zgjedhjet në katër komunat

veriore të Kosovës nesër do të jenë në krye të Zajebnicës dhe se do ta zbatojnë "vetëmenaxhimin"? Këta e kanë jetëgjatësinë e kryetarllëkut së një fluturë, ndoshta as edhe aq. Nëse e kanë refuzimin apo mungesën e bashkëpunimit e pjesës dërrmuese të qytetarëve të këtyre komunave, në shërbim të kujt do të jenë atëherë?! Po si do të vendosen në zyra në objekte komunale aktuale, me flamuj të Serbisë dhe ikonografi serbe?! Në mungesë të zyrave të mirëfillta ata do të shndërrohen në kryetarë të kontejnerëve, ashtu si ishin edhe votuesit e tyre. Në vend se t'i përgjigjen Faraonit, ministrit për pushtet lokal ata do të jenë nën përgjegjësi të Xheluas.

Tash, pas këtyre zgjedhjeve, të orkestruara nga ndërkombëtarët, pa asnjë dyshim, LV-ja dhe PDK-ja po i fërkojnë duart, si fitues thuaj që kanë fituar mbi 200.000 vota e jo që nuk i kanë fituar as edhe 750 vota, për parti. Ani ky i LV-së, si Hanibali ante portas (para deryve), botërisht deklaroi se do të jetë kryetar i të gjithë qytetarëve dhe se e presin projekte të mëdha për Mitrovicën e Veriut. Merreni me mend po të kishte ky farë tipi pushtet të vërtetë?! Me gjasë ky do të jetë Hanibali i Mitrovicës së Veriut i cili do të përfundojë, jo para deryve të komunës por para deryve të kontejnerit ku do të kufizohet pushteti real i tij, sikur edhe për tre kryetarët tjerë!

Diçka po ndodhë në këtë kohë dhe në këtë vend, me Jeton Qyroja, sozisë së ministres për punë të jashtme, bijë dhe bija të ish-shërbyesve jugosllavë dhe serbë, me rrenca dhe mashtrues në poste me rëndësi, me negociator si Bisla i Muçibabes dhe "ma (r)garitarë të ngjashëm, retë e zeza do të qëndrojnë gjatë mbi Kosovën. Albin Kurti ose me vetëdije po e luan rolin e Hamletit, ose nuk është i vetëdijshëm se po ia punojnë nën brezë! E para nuk i falet, e dyta mund t'i merret si rrethanë lehtësuese! E shohim, e shohim, shumë shpejtë, madje!



BE-ja, Ministria e Kulturës dhe UNDP-ja ndihmojnë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës

PRISHTINË, 25 PRILL - Për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Lokaliteteve, Tomas Szunyog, ambasador i BE-së në Kosovë, Hajrulla Çeku, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, vizituan në Prizren Katedralen e Zojës Ndihmëtare dhe Muzeun e Hidroelektranes. Të dyja këto vende të trashëgimisë kulturore po restaurohen përmes projektit

të financuar nga Shërbimi për Instrumentet e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian (FPI) dhe të zbatuar nga UNDP, i quajtur "Trashëgimia Kulturore si Shtytëse e Dialogut Ndërkomunitar dhe Kohezionit Social". "Trashëgimia e pasur kulturore e Kosovës është lidhja jonë me të kaluarën dhe mësuesi ynë për të ardhmen. Flet për tolerancën, miqësinë dhe bashkëjetesën, të cilat janë më se të nevojshme në botën ku jetojmë", ka thënë Szunyog,

duke shtuar se përmes Instrumentit për Asistencë të Para-Aderimit dhe Instrumentit të Politikës së Jashtme, BE-ja ka ndihmuar në restaurimin e 56 vendeve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë, ndër të tjera, xhamitë, kishat, vendet arkeologjike dhe kulturore dhe muzetë. "Ne do të vazhdojmë të kontribuojmë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës për të gjitha komunitetet dhe gjeneratat që vijnë", ka deklaruar Szunyog.



Reagim i KMDLNj-së

A do të kompensohen qytetarët e Kosovës për rrymën e pashpenzuar?

Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë vendim që qytetarët Kosovës, pagues të rregullt të faturave të rrymës të kompensohen, që për vite të tëra janë plaçkitur nga ZRrE përmes fryrjes së faturave për t'ua paguar rrymën serbëve në veri të Kosovës, të cilët, as sot e kësaj dite nuk e paguajnë rrymën, ujin, mbeturinat e as shërbimet tjera komunale. Realisht, nuk tregohet forma e kompensimit në ndërkohë që ZRrE do të shfrytëzojë të drejtën e ankimit. KMDLNj, në vazhdimësi ka reaguar kundër këtij diskriminimi që ua kanë bërë qytetarëve të Kosovës ZRrE dhe operatori për energji për faktin se kundërligjshëm iu është faturuar edhe energjia të cilën nuk e kanë shpenzuar. Në këtë kontekst gjithnjë ka kërkuar që qytetarëve t'iu kthehen mjetet e plaçkitura nga ZRrE por se nuk kishte ndonjë vendim urdhëruar nga Gjykata kompetente që ta bëjë kompensimin. Në takim me ish-kryeministrin Ramush Haradinaj, KMDLNj kishte kërkuar që qeveria mos t'ua paguaj më rrymën serbëve dhe joserbëve në veri të Kosovës sikur që qytetarët e plaçkitur të kompensohen për aq mjete që iu janë marrë në mënyrë të kundërligjshme. Edhe Komisioni parlamentar pati

konstatuar se faturimi ishte i kundërligjshëm siç ishte edhe shlyerja e borxheve për serbët dhe të tjerët në veri të Kosovës. Pas vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për kompensim të qytetarëve të dëmtuar nga veprimi i kundërligjshëm dhe kriminal i ZRrE-së, në opinion po diskutohen mundësitë e forma dhe shuma që duhet të kompensohet. Në ndërkohë ZRrE, me pajtim jonormal të qeverisë, rriti faturat e energjisë për 15 për qind në ndërkohë që edhe në këtë rast përfitues janë ata që asnjëherë nuk kanë paguar asnjë faturë për rrymën e shpenzuar të cilëve nuk iu bënë përshtypje as rritja e faturave edhe po të ishte 1000 për qind. Periudha e kompensimit, nëse edhe do të ketë kompensim, nuk është reale, duhet të përfshihet një periudhë më e gjatë. Qytetarët në asnjë mënyrë nuk duhet të pranojnë kompensimin, nëse ndodhë kompensimi, përmes "uljes" së vlerës së faturave sepse nuk do të përfitojnë asgjë nga ky kompensim, do të mashtrohen siç janë mashtuar deri më tani. Nuk ka mekanizëm që do ta monitoronte rregullsinë e kompensimit. Qytetarët e Kosovës, të dëmtuar nga veprimi kriminal i ZRrE-së përmes fryrjes së faturave



duhet të këmbëngulin që kompensimi, nëse bëhet kompensimi, të bëhet me para duke e llogaritur kamatën ligjore sikur edhe çmimin e tarifave që duhet të jenë të kohës kur janë dëmtuar e jo me çmimore të sotme. Kjo do të ishte minimumi në bazë të cilit do përfitonin qytetarët e dëmtuar. Krahas kërkesës për kompensim i cili do të jetë në baza individuale, të gjithë ata që do të kërkonin kompensim, kësaj kërkesë duhet t'i bashkëngjitin edhe një kallëzim penal në mënyrë që ZRrE të mos kalojë pa pasoja ligjore shkak të veprim, fryrje të faturave për rrymën e pashpenzuar që përbënë të gjitha elementet e

veprës penale. Një goditje e radhës për shumicën e qytetarëve të Kosovës ishte rritja e shumëfishuar e tatimit mbi pronën që u përfshi në faturat e vitit 2023, pa një njoftim paraprak për qytetarët e Kosovës. Me këtë rritje, në disa raste kishte fatura më të larta se 400 - 500 për qind krahasuar me vitin paraprak. Ishte një reagim i fuqishëm që pastaj vuri në lëvizje përpjekjet të dilet, vetëm përkohësisht nga kjo situatë. Ministria e Financave, pa asnjë bazë ligjore propozoi që të gjithë tatimpaguesve t'iu shlyhen 100 euro, mbase si lëmoshë amortizuese por që nuk e zgjidhë çështjen në planin

afatgjatë. E që nënkupton se këtë vit liroheni për 100 euro kurse në vitet vijuese faturat dërgohen me rritje jonormale që i bëri kjo ministri. Komunitat u gjetën në situatë kur nuk mund të zbatojnë një falje prej 100 eurove pa një bazë ligjore kurse Ministria e Financave ka filluar nismat ligjore që ky propozim të përligjet. Tash, komunitat nuk janë të kënaqura me këtë propozim shkak se, sipas tyre do të humbin miliona e miliona euro. Qytetarët janë në pikë të hallit me këtë lojë ping-pong midis Ministrisë së Financave dhe komunave për faktin se nëse deri në fund të muajit prill 2023 nuk e paguajnë këstin e parë, do të kenë kamata ndëshkuese. KMDLNj ka propozuar dhe propozon që kësti i dytë të paguhet deri në fund të vitit kalendarik e jo që qytetarët të detyrohen që këtë këst ta shlyejnë deri në fund të muajit tetor dhe çdo vonesë shoqërohet me kamata ndëshkuese. KMDLNj kërkon nga komisionet përkatëse parlamentare që të reagojnë, sa i përket kompensimit të rrymës ashtu edhe për tatimin në pronë për faktin se edhe në të dytin kemi të bëjmë me shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

Kurti: Fuqizimi i grave në biznes, fuqizim i ekonomisë në përgjithësi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në Javën e Pronësisë Industriale dhe Inovacionit, "Gratë dhe pronësia intelektuale: nxitja e inovacionit dhe kreativiteti", organizuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Kurti në fillim të fjalës së tij tha se "gratë na e kanë dëshmuar që janë protagoniste, si ndërmarrëse e si punëtore e sot janë shumë aktive në botën e digjitalizuar e të inovacionit, por edhe në bujqësi, në shërbime, në gastronomi, rrobaqepësi e prodhim". Duke përmendur shembuj nga e kaluara, ku gratë kanë siguruar mundësi e kanë shpikur forma të burimeve financiare, kryeministri Kurti tha se janë të panumërta gratë që insistojnë në biznes e zhvillim të projekteve, andaj ne detyrohemi dhe obligohemi t'i përkrahim ato që janë në fillim të nismave të tyre. Ai, gjithashtu, tha se gratë kanë

pasur më shumë sfida gjatë përvojave jetësore e të karrierës, prandaj si qeveri jemi të vëmendshëm për këto dallime që në fëmijëri dhe jemi duke ndërhyrë kudo që është e mundur si përmes edukimit në fëmijërinë e hershme, ndarjen e bursave vetëm për vajzat studente në ato lëmë që kanë qenë të populluara kryesisht prej djemve studentë. "Qeverisja jonë ka ndërmarrë disa veprime që ndërhyjnë dhe ndikojnë në ekonominë drejt barazisë dhe zhvillimit dhe qëllimi ynë si qeveri është të mos e lëmë askënd në gjendje të pasigurisë financiare", ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka thënë se me masat mbështetëse të qeverisë subvencionuan kreditë investuese të mbi 200 bizneseve prodhuese, ku vlera e akreditimit të mundësuar ishte mbi 100 milionë euro. "Mbështetëm 268 biznese, 40 për qind prej tyre në pronësi të grave, me vlerë 11.2 milionë euro, për shtim të kapaciteteve prodhuese për eksport e me



teknologji të avancuar. Nga projekti 'Iniciativa për fuqizim digjital' përfituan 62 ndërmarrje, prej tyre 35 në pronësi nga gratë, pra ma shumë se gjysma. Për dy vjet janë punësuar rreth 5 mijë gra dhe është rihapur thirrja për biznese për mbështetje të 50 për qind të pagës për 3 muajt e parë nëse punësojnë gra. E, afër 1 500 familje kanë të paktën një anëtar të punësuar, prej tyre 603 gra, nëpërmjet masës 'Qeveria

për familje", është shprehur Kurti. Ai ka theksuar se duhen eliminuar diskriminimi dhe pengesat e shumëfishta të cilat krijohen veçanërisht duke u bazuar në gjini, por nganjëherë edhe në origjinën etnike e shoqërore, moshën apo edhe gjendjen social-ekonomike. "Qëllimi ynë si qeveri është të pasigurisë financiare. Vetëm me politikën tonë të re, për shtesat

për lehonat dhe fëmijë, afër 90 mijë gra për herë të parë kanë hapur llogari bankare. Në Kosovë, por edhe në shumicën e vendeve të botës, kredi marrin më shumë burrat sesa gratë. Ky krahasim është duke lëvizur çdo ditë dhe duhet të shkojë në një qasje më të barabartë. Arsyet pse gratë kërkojnë kredi janë në të shumtën e rasteve më të arsyeshme e më dobiprurëse sesa ato për të cilat kërkojnë burrat", ka thënë Kurti.

A është e pashmangshme një ekonomi kapitalisto-socialiste?

Për një sërë arsyes, sistemi aktual ekonomik nuk funksionon më për shumë njerëz. A është përgjigja për të kaluar në një ekonomi (më shumë) hibride dhe a është ky tranzicion i pashmangshëm?

Ka një sërë problemesh ekonomike me të cilat përballet shoqëria jonë. Pabarazia në të ardhura, si brenda dhe ndërmjet kombeve, po rritet në nivele të para në shekullin e 14-të. Efektet anësore të shumë industrive, si ndotja, shfrytëzimi dhe dëme të tjera sociale, vazhdojnë të shkatërrojnë pjesë të mëdha të botës. Dhe një numër gjithnjë e më i madh njerëzish po hasin vështirësi për të përballuar jetesën ndërsa janë të rrethuar nga pasuria materiale.

Ndërsa debati rreth këtyre problemeve dhe zgjidhjeve të mundshme vazhdon, lind pyetja: A është e pashmangshme një ekonomi kapitalisto-socialiste?

Pse status quo-ja nuk funksionon

Sistemi aktual ekonomik thjesht nuk po funksionon për shumë njerëz, sipas Timothy Snyder, Levin Profesor i Historisë në Yale:

“Shtetet e Bashkuara janë një vend që është ndër më pak të barabartët në botë. Sipas Credit Suisse, e cila është një bankë zvicerane dhe jo një lloj organizate e çmendur e majtë, ne jemi të dytët në botë në pabarazinë e pasurisë pas Federatës Ruse. Në Shtetet e Bashkuara që nga vitet 1980, në thelb 90 për qind e popullsisë amerikane nuk ka parë asnjë përmirësim as në pasuri, as në të ardhura. Pothuajse i gjithë përmirësimi në pasuri dhe të ardhura ka qenë në dhjetë përqindëshin e parë dhe pjesa më e madhe ka qenë në një përqindëshin më të lartë dhe pjesa më e madhe e kësaj ka qenë në 0.1 përqindëshin e parë dhe pjesa më e madhe e kësaj ka qenë në 0.01 përqindëshin më të lartë, që do të thotë që njerëzit jo vetëm që nuk ecin përpara objektivisht, por mënyra se si ata e përjetojnë botën – dhe kjo është shumë ndjesi e fuqishme – është se njerëz të tjerë janë në krye.”

Që ekonomia nuk funksionon për të gjithë nuk është një ide e re. Megjithatë, sipas autorit Anand Giridharadas, ideja se tregjet do të rregullonin gjithçka është shtyrë edhe kur provat kundër saj janë në dispozicion:

“Ka një mënyrë në të cilën elitat amerikane, dhe nuk po flas vetëm për disa miliarderë lakmitarë, por edhe intelijenca amerikane ka qenë bashkëfajtores në një histori të

rreme. Njerëz të pasur dhe korporata të pasura kaluan një brez duke bërë një luftë kundër qeverisë, duke definuar qeverinë, duke lejuar që problemet sociale të acarohen dhe duke lejuar që fitimet e tyre të rriteshin.... Mbjaj mend isha ulur në Michigan në lëndën Econ 101 dhe më kujtohet se si merrja një leksion që thoshte se të gjitha këto gjëra ishin për të mirë dhe do të bëheshim më mirë. Dhe pikërisht rrotull nesh, në Michigan në 1999 shteti po shpërbëhej.”

Dr. Ioannis “Yanis” Varoufakis, ish-ministër i Financave i Greqisë thotë se dështimet e sistemit tonë aktual prekin të gjithë:

“Ne kemi miliarda njerëz që punojnë si pula pa kokë, duke e zhytur veten në depresion dhe duke shkuar në shtëpi e duke qarë natën deri sa i zë gjumi nëse kanë një punë, ose duke konsumuar ilaçet kundër depresionit dhe duke u bërë obezë dhe duke vizituar psikologë nëse nuk kanë punë. Në fund të fundit, ne kemi një ekonomi pa gëzim. Edhe ata që janë jashtëzakonisht të fuqishëm, në teori, të pasurit e botës, po ndihen gjithnjë e më shumë të pasigurt. Ata duhet të jetojnë në komunitete të mbyllura, sepse kanë frikë nga të gjithë ata që nuk kanë dhe që e kanë zili pasurinë e tyre. Në fund, ne kemi zhvilluar mjete fantastike për t'i shpëtuar nevojës dhe për t'i shpëtuar dëshirave, të cilat nuk po i përdorim mirë, sepse, në fund, po zhvillojmë forma të reja të shthurjes dhe privimit dhe depresionit të universalizuar, depresionit psikologjik, i cili nuk është në përputhje me përparimet tona fantastike në nivelin teknologjik.”

Pra, tani që po diskutojmë alternativat ndaj neoliberalizmit, cilat opsione janë në tryezë?

Si të përzieret një ekonomi e përzier

Sistemi aktual ekonomik i favorizuar nga shumica e vendeve të industrializuara është “ekonomia e përzier”. Ky përshkruhet më së miri si një sistem kapitalist me elementë të një ekonomie të planifikuar. Nuk është asgjë e re; versionet e tij i paraprijnë Romës. Pyetja që debatohet në shumicën e vendeve nuk është nëse duhet të ketë një përzierje tregjesh dhe ndërhyrjeje shtetërore, por më tepër se cila duhet të jetë ajo përzierje. Sot, ne jemi në një



epokë ku tregjet më të lira dhe me më pak ndërhyrje janë qasje popullore, por ky është një zhvillim mjaft i ri.

Disa dekada më parë, edhe vendet kapitaliste përdornin planifikimin. Për shembull, në Francë, qeveria drejtoi ekonominë e përqendruar te tregu nëpërmjet përdorimit të planifikimit indikativ, një lloj planifikimi ekonomik në të cilin qeveria vendos objektiva dhe prioritete të përgjithshme për zhvillimin ekonomik, por nuk kontrollon drejtpërdrejt prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve. Kjo politikë ishte në fuqi për dekada të tëra, të njohura tashmë si “Tridhjetë Vitet e Lavdishme”. Politika të ngjashme ekzistonin në Japoni dhe Indi.

Në vendet nordike dhe në Kinë, shteti zotëron ose kontrollon një pjesë të madhe të shumë ndërmarrjeve. Në Norvegji,

industria e naftës është në pronësi të qeverisë dhe investon në mënyrë aktive në kompani të tjera. Ndërsa pronësia shtetërore ka rënë në Skandinavi, qeveritë e ndryshme ende zotërojnë shumë biznese në shumë industri. Në jug të Shteteve të Bashkuara, qeveria federale ende zotëron dhe operon Autoritetin e Luginës së Tennessee.

Edhe vendet më të orientuara nga tregu mbështeten në ndërhyrjen e shtetit – si rregullimi, mirëqenia dhe politika makroekonomike – për të korrigjuar dështimet e tregut. Kalimi drejt një modeli me më shumë ndërhyrje do të ishte mjaft i lehtë për sa i përket zbatimit të politikave. Ne e kemi bërë më parë, është thjesht një çështje nëse duam përsëri.

Shumica e ekonomive të mëdha sot funksionojnë në një përzierje të kapitalizmit dhe

socializmit. Duke pasur parasysh problemet me të cilat përballen sot shumë ekonomitë industriale, një rivlerësim i asaj cilën përzierje po përdorim mund të jetë në rregull. Partia e Dr. Varoufakis bën thirrje për socializëm të tregut. John Fullerton ka shtyrë për një rimagingim të mënyrës se si i qasemi ekonomisë dhe së fundmi shkroi një libër mbi ekonominë rigjeneruese. Wendell Pierce, një aktor dhe biznesmen, e konsideron veten një “kapitalist të vërtetë” ndërsa bën thirrje gjithashtu për rritjen e shërbimeve sociale, siç është përmirësimi i arsimit publik.

Çfarëdo që të zgjedhim, do të bënim mirë të kujtonim fjalët e ish-udhëheqësit kinez Deng Xiaoping: “Nuk ka rëndësi nëse një mace është e zezë apo e bardhë, për sa kohë që kap minjtë”. / Big Think Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Kosova në grup me Zvicrën dhe Danimarkën

PRISHTINË, 25 PRILL - Është hedhur shorti për rrethin e tretë parakualifikues për FIBA Eurobasket 2025. Kosova ndodhet në Grupin H, së bashku me Zvicrën dhe Danimarkën. Dy ndeshje do

të zhvillohen si vendës dhe dy si mysafirë. Fituesi i secilit grup (katër grupe gjithsej) do të kualifikohet në rrethin e dytë Parakualifikues 2025, ndërsa datat e ndeshjeve shumë

shpejt do të bëhen të ditura. Kjo është hera e parë që Kosova A do të luajë me Zvicrën, ndërsa me danezët jemi përballur së fundi, ku "Dardanët" kanë një fitore 78:73 dhe një humbje 105:71.

Grupi H

Zvicra
 Danimarka
 Kosova



Osmani për licencimin e FFK-së: Po shqyrtohet dosja e re e klubeve, s'do të ketë asnjë lëshim

PRISHTINË, 25 PRILL - Zëvendësministrja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, ka bërë me dije se procesi i licencimit të Federatës së Futbollit të Kosovës është afër përfundimit, por kjo do të varet nëse dokumentacioni i ri i sjellë në këtë ministri nga klubet e futbollit është në rregull. Osmani ka thënë se dosja e re me dokumente të klubeve tashmë është duke u shqyrtuar nga Komisioni për Licencim dhe nëse ato i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas udhëzimit administrativ, atëherë FFK-ja do të licencohet menjëherë. "Përkundër federatave të tjera, nuk është vetëm futbollit ajo e cila po sfidohet me këtë proces. Të gjitha ato që janë licencuar kanë hasur në vështirësi të mbledhjes së dokumentacionit

që kërkohet sipas udhëzimit administrativ, mirëpo Federata e Futbollit tashmë siç edhe është bërë publike, është në prag të përfundimit të plotësimit të të gjitha kriterëve. Federata i ka plotësuar të gjitha kriteret në një formë apo tjetër, mirëpo janë klubet ato që tani nëse nuk gabojnë të enjten që ishte dita e fundit e punës në institucionet publike kanë sjellë dosjen e re me të gjitha komentet të cilat i kanë pranuar nga Komisioni për Licencim dhe komisioni gjatë kësaj jave do ta trajtojë. Urojmë që dokumentet të jenë të kompletuara dhe të mos ketë nevojë për kthim prapa përsëri", ka thënë Osmani për KP. Në lidhje me këtë çështje, në fillim të javës së kaluar në Kosovë ishte për vizitë një



delegacion nga UEFA dhe FIFA. Osmani ka bërë me dije se ata janë njoftuar me të gjitha hollësitë e licencimit të FFK-së dhe se ata i kanë dhënë mbështetje këtij procesi. Për

shkak të moslicencimit të Federatës së Futbollit, klubet janë ankuar se po humbin miliona euro nga pamundësia për ta shfrytëzuar Ligjin e Sponsorizimit, por Osmani ua

ka bërë të qartë se nuk do të ketë asnjë lëshim në këtë proces për klubet. Sipas saj, nëse këto klube kanë fituar miliona euro nga ky ligj, atëherë ato duhet të jenë në gjendje t'i përgatitin dokumentet që kërkohen për licencim. Së fundi, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, është liruar nga arresti shtëpiak, por Osmani thotë se nuk është takuar e as nuk ka pasur ndonjë kontakt me të rreth zhvillimeve të fundit. Sipas saj, kryetari nuk duhet të merret me procesin e licencimit pasi është proces teknik. Procesin e licencimit deri më tani, Osmani ka njoftuar se e kanë kaluar 24 federatat, ndërsa ka bërë thirrje që edhe federatat e tjera ta plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e kërkuar për ta marrë licencën nga ana e Ministrisë së Sportit.

Broja: Kemi talentin për ta çuar Shqipërinë për herë të parë në Kupën e Botës

LONDËR, 25 PRILL - Kombëtarja e Shqipërisë ka shumë talente në radhët e veta si Armando Broja, Kristjan Asllani, Marash Kumbulla dhe Nedim Bajrami. Sulmuesi Broja në një intervistë për revistën prestigjioze "World Soccer" ka shprehur optimizëm se me grupin që kanë kuqezinjët, kualifikimi në Kupën e Botës është shumë i mundur. "Është shumë emocionuese të jesh pjesë e një skuadre me disa lojtarë të rinj

shumë të veçantë, gjithashtu është e rëndësishme përvoja që kemi si grup, që vepron si një përzjerje e mirë. Ka të bëjë me vendosjen e të gjithëve në të njëjtën situatë dhe Sylvinho – së bashku me ndihmësin e tij Pablo Zabaleta – e kuptojnë këtë. Nuk kam asnjë dyshim që kemi plot talent aty dhe është një nder i vërtetë për mua të jem pjesë e këtij projekti. E pamë atë që bëri Maroku në Kupën e Botës dhe besojmë se



nuk ka asnjë arsye pse ne si grup të mos e përsëritim diçka

të ngjashme në të ardhmen. Ne kemi talentin për ta çuar Shqipërinë në Kupën e Botës për herë të parë në historinë e saj", ka thënë Broja. Sulmuesi i Chelseat ka folur edhe për trajnerin e Shqipërisë, Sylvio Mendes Campos Junior. "Po, kemi folur disa herë dhe ai erdhi në Angli për të më takuar. Ai është një person shumë i mirë dhe ka një vizion të qartë e të drejtpërdrejtë se ku dëshiron ta çojë ekipin. Është shumë

inkurajuese. Ai ndan ambicien time për të shkuar në finalen e një Botërori dhe Evropiani me Shqipërinë, por ne nuk kemi asnjë iluzion për faktin se ky objektiv do kohën e vet. Ashtu si edhe te Chelsea, duhet durim për t'i sjellë të gjithë në të njëjtën rrugë kur ka ndryshime në dhomat e zhveshjes, por nuk kam asnjë dyshim se Sylvinho do të ketë një ndikim të madh dhe pozitiv në ekip", ka shtuar Broja.

Dy sportistë të teqballit konfirmohen për Lojërat Evropiane

PRISHTINË, 25 PRILL - Sporti i teqballit për herë të parë do të përfaqësohet në Lojërat Evropiane Krakow dhe Malopolska 2023 të cilat prej 21 qershorit deri më 2 korrik 2023 mbahen në rajonin e Krakowit dhe Malopolskas së Polonisë. Me këtë rast, Kosovës i janë konfirmuar dy kuota për pjesëmarrje në

konkurrencën e meshkujve. Kualifikimi ka ardhur pas renditjes së mirë të lojtarit Adrien Uka, i cili ndodhet në vendin e 26 të renditjes botërore. Falë tij, një kuotë i është mundësuar edhe Krenar Emini, ku të dy do të garojnë në disiplinën individuale dhe çifte. Uka karrierën e zhvillon në Francë, ndërsa prej dy

vjetësh e përfaqëson Kosovën në garat ndërkombëtare të teqballit. Emini ka marrë pjesë në garat ndërkombëtare gjatë këtij viti dhe është duke kërkuar përvojë në gara të nivelit të tillë. Kosovës më herët i është konfirmuar edhe një kuotë me Arbër Bajran në taekwondo, ndërsa ekipi ynë do të përbëhet edhe me një

numër të madh të sportistëve të atletikës dhe boksierëve, për të cilët Lojërat Evropiane vlerësohen edhe si Kampionat Evropian. Edhe pse ende jo zyrtarisht, në ditët në vijim pritet të kemi konfirmim për pjesëmarrje edhe në sportet e shenjtarisë sportive, shigjetarisë, çiklizmit dhe kajakimit.



UEFA mund ta përjashtojë, Juve rrezikon pjesëmarrjen në garat evropiane

TORINO, 25 PRILL - Juventus ka fituar betejën e parë, por jo luftën. Vendimi i Kolegjit të Garancisë së Sportit në CONI, për t'ia kthyer Zonjës së vjetër pikët që i ishin hequr për mashtrim me bilancet, nuk është aspak përfundimtar. Topi tani i ka kaluar Gjykatës Federale të Apelit. Megjithatë,

koha nuk premton dhe UEFA nuk mund të presë. Organi më i lartë i futbollit evropian duhet t'i formësojë kompeticionet për sezonin e ardhshëm dhe, nëse drejtësia italiane nuk vendos para fundit të korrikut, do të jetë paneli i "fair-play"-it i UEFA-s që do të vendosë, në mënyrë të pavarur,

mbi sanksionin e vendosur ndaj Juventusit. Kujtojmë se Prokuroria e Torinos i ka dërguar UEFA-s të gjitha dokumentet përkatëse dhe organizata e drejtuar nga Aleksander Ceferin po e shqyrton vetë çështjen. "La Gazzetta dello Sport" paralajmëron se "dënimi i

drejtuesve dhe konfirmimi se ka pasur 'sjellje josportive' nuk u ndihmon 'bardhezinjve'. Madje sheh mundësinë që UEFA ta ndëshkojë Juventusin me një ose dy sezona jashtë Evropës. Një sanksion që mund të zgjatet në kohë në rast se Juventus nuk fiton Ligën e Evropës (përballet



me Sevillan në gjysmëfinale) – ose nuk kualifikohet në garat evropiane.

Jesus sfidon të kaluarën: Vështirë ndaj Cityt, por duhet të fitojmë

LONDËR, 25 PRILL - Manchester City dhe Arsenali do të përballen të mërkurën në kuadër të Premierligës. Për këdo mund të jetë një ndeshje e zakonshme kampionati, por jo për Gabriel Jesusin, i cili tashmë do ta sfidojë të kaluarën e tij. Sulmuesi brazilian iu bashkua Arsenalit në verë nga ekipi i "Qytetarëve". Para takimit shumë të rëndësishëm për titullin, ai ka folur gjatë duke pranuar se nuk do të jetë ndeshje aspak e lehtë. "Shumë gjëra kanë ndodhur kohët e fundit, por ne mbetemi pozitivë. Është fantastike ajo që po bëjmë këtë sezon. Premierliga është një kampionat shumë i fortë. Është e vështirë ta fitosh. Duhet të qëndrojmë të bashkuar deri në fund. Mos të harrojmë se kemi një avantazh prej pesë pikësh. Sezoni nuk ka përfunduar ende. Tani vijmë ndeshjet e vështira. Manchester City ka luajtur dy ndeshje më



pak", ka thënë ai. "Nëse duam ta fitojmë titullin duhet të shkojmë në 'Etihad' dhe ta fitojmë ndeshjen. Kaq e thjeshtë është... Jemi skuadra më e re e Premierligës, por nuk duhet të justifikohemi me këtë fakt. Ndonjëherë bëjmë mirë, në raste të tjera gabojmë. Prandaj

është kaq e rëndësishme të qëndrojmë të bashkuar. Nuk jemi aspak të lumtur me atë që kemi bërë në tri ndeshjet e fundit. Kemi humbur pikë, kemi ulur nivelin e përqendrimit, por kjo është Premierliga. Nuk është aspak e thjeshtë të shpalleh kampion", ka deklaruar Jesus.

Miami mposht Milwaukee, Lakersat fitojnë pas kohës shtesë

MILWAUKEE, 25 PRILL - Vijon të befasojë ekipi i Miamit, që mundi me rezultat 119-114 Milwaukee në ndeshjen e katërt çerekfinale "play-off" dhe tashmë udhëheq 3-1 serinë. Një rezultat që nuk pritej, pasi Miami erdhi nga faza "play-in", ndërsa Milwaukee ka rekordin më të mirë sezonal në NBA. Rikthimi i Antetokounmpos nuk zgjidhi problemet e Bucksit



edhe pse realizoi një "triple double" me 26 pikë, 10 rebounde e 13 asistime, ndërsa Middletoni shënoi 36 pikë. Për Miamin u dallua Jimmy Butler, autor i 56 pikëve, lider në fushë për vendësit, që janë një fitore larg kualifikimit. Një fitore larg është edhe ekipi i lakersave, që e

mposhti me shifrat 117-111 Memphisin pas kohës shtesë. Të gjithë titullarët e lakersave e mbyllën me mbi 10 pikë, ku u dalluan Reavesi me 23 pikë e LeBron Jamesi me 22 pikë e 20 rebounde. Për Memphisin, Bane realizoi 36 pikë, por që mbetën për statistikë.

"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE KONFERENCA E LINDJES

Philadelphia - Brooklyn	(4-0)
Boston - Atlanta	(3-1)
Cleveland - New York	(1-3)
Milwaukee - Miami	114-119 (1-3)

"PLAY-OFF" - ÇEREKFINALE KONFERENCA E PERËNDIMIT

Sacramento - Golden State	(2-2)
Memphis - Lakers	111-117 (1-3)
Phoenix - Clippers	(3-1)
Denver - Minnesota	(3-1)

SHKURT

Shefi i Mercedesit: Menduam se ishim përmirësuar, por jemi ende në vendnumëro

Sezoni 2023 nuk ka nisur shumë mirë për Mercedesin, që vijon të jetë forca e tretë në Formula 1. Nga skuadra gjermane pritej më shumë, por ende nuk ka ardhur momenti që Mercedesi të korrë një fitore. "Deri më tani sezoni ka qenë i vështirë për ne", u shpreh Toto Wolff, shef i Mercedesit. "Me mënyrën se si punuam gjatë dimrit shpresonim se do t'i kishim zgjidhur problemet e vjetshme. Kuptuam se nuk kemi arritur aty ku dëshironim. Pas tri garave të para kemi parë vetëm një makinë që nuk ka probleme dhe është një pikë referimi për ne: Red Bull", ka thënë Wolff. "Në garën e fundit në Australi pamë disa përmirësime të vogla në makinën tonë, ndërkohë që ky pushim i gjatë na dha mundësi të rikuperojmë diçka. Nuk duhet të kalojmë që tani në depresion për faktin se nuk jemi në gjendje të rikuperojmë sa duhet. Do të kemi shumë përmirësime përpara", ka deklaruar Wolff.

Ancelotti: Do të ishte mirë që Messi të rikthehej në La Liga

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, shprehet se do të ishte mirë që Leo Messi të rikthehej në La Liga, pavarësisht që me rikthimin e tij Barcelona do të përbente kërcënim për Realin. Kohët e fundit flitet se Messi është shumë pranë rikthimit dhe se Barcelona është duke u përpjekur me të gjithë mundësitë që ka për ta bërë realitet këtë gjë. Ancelotti u shpreh se do të ishte tepër i lumtur ta shihte sulmuesin argjentinas të rikthehej në La Liga. "Messi mund të bëjë çfarë të dojë dhe Barcelona gjithashtu. Nuk është një çështje për mua. Më pëlqen Messi si lojtar. Për futbollin spanjoll mund të jetë diçka e mirë ta kesh atë, por kjo çështje i takon Messit dhe Barcelonës", ka thënë Ancelotti.

Edhe Lukaku në listën e Bayernit

Bayern Munchen është në kërkim të një sulmuesi qendror për sezonin e ardhshëm. Nga largimi i Robert Lewandowskit, Bayerni ka pasur jo pak probleme në shënimin e golave dhe drejtuesit "bavarezë" kanë përpiluar një listë me sulmuesit që i pëlqejnë. I pari është sulmuesi i Napolit, Victor Osimhen, pastaj ai i Tottenham Hotspurit, Harry Kane dhe tash kësaj liste i është shtuar edhe Romelu Lukaku. Aktualisht sulmuesi belg është i huazuar nga Chelsea në Inter dhe ende nuk ka asnjë vendim për të ardhmen e tij, prandaj Bayerni mund të përfitojë nga ky rast.

Unitedi monitoron situatën e Neymarit në PSG

Neymar Jr mund të largohet nga Paris Saint-Germaini në afatin kalimtar të verës. Sulmuesi brazilian që një kohë po pëlqehet nga klubet angleze, mbi të gjitha nga Chelsea. Por tash, në garë për ish-futbollistin e Santosit dhe të Barcelonës është futur edhe Manchester Unitedi. Lajmin e ka dhënë mediumi francez "Foot Mercato". Gjithnjë sipas këtij mediumi, "Djajtë e Kuq" janë duke e vëzhguar me kujdes situatën e përfaqësuesit brazilian dhe po mendojnë ta shfrytëzojnë rastin për ta transferuar atë në "Old Trafford". Përvoja e Neymarit në Paris është përshkuar me rënie dhe me ngritje, përfshirë këtu lëndimet, formën e zbehtë, por edhe formën optimale të shfaqur kohë pas kohe, por pa vazhdimësi.

Totti: Roma nuk duhet ta largojë trajnerin, besoj te Mourinho

"Me Jose Mourinho në krye, skuadra e Romës mund të shkojë shumë larg në Ligën e Evropës apo në Ligën e Kampionëve sezonin tjetër. Ne si tifozë të këtij ekipi jemi krenarë

për këtë ekip dhe trajnerin", u shpreh legjenda e Romës, Francesco Totti, në një intervistë për DAZN. Pavarësisht prej humbjes 3-1 që Roma pësoi nga Atalanta në Serinë A, ish-

kapiteni i Romës mendon se ky ekip ka të ardhme me Jose Mourinhon në krye. "Këtë sezon po shohim një Romë që ka dy pamje të ndryshme, një në kampionat e një në Evropë. Në

Ligën e Evropës ekipi i Romës luan shumë më mirë", ka deklaruar Totti. "Janë 4-5 skuadra që synojnë një vend në Ligën e Kampionëve sezonin tjetër ndaj arritja e këtij objekti është e

vështirë. Gjithsesi, ky ekip dhe ky trajner kanë një filozofi fituese, ndaj duhet t'i mbështetni dhe të mos mendojmë ta largojmë trajnerin. Unë besoj te Mourinho", u shpreh Totti.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i punës/Pozita: Auditor i Lartë
 Departamenti: i Auditimit të Brendshëm (DAB)
 I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm
 Niveli i gradës: 4

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës:

Auditori i Lartë kryen auditime financiare, të pajtueshmërisë, teknologjisë informative, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me standardet për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe bën vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve.
 Auditori i Lartë punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat, si dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raporte, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilat rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante) duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transakcionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Drejtorit të DAB-it, apo vetë departamentit.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të punonjësve në Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Departamentit të Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, kontabilitetit, menaxhmentit, apo juridike;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune, tri (3) prej të cilave në fushën e auditimit të brendshëm apo të jashtëm;
- Çertifikatë profesionale në fushën e auditimit të sektorit publik/privat;
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioritetëve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 maj 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta / pozicija: Viši revizor
 Departman: za unutrašnju reviziju (DUR)
 Izveštava: Direktor Departmana za unutrašnju reviziju
 Nivo stepena: 4

Svrha i delokrug pozicije

Viši revizor vrši finansijske revizije, usklađenosti, informacione tehnologije, reviziju Menadžmenta kao i preliminarno istraživanje određenih operativnih i funkcionalnih aktivnosti u skladu sa standardima za profesionalnu praksu unutrašnje revizije, kao i ocenu efikasnosti unutrašnjih kontrola ovih aktivnosti.

Viši revizor radi pod direktnim nadzorom direktora Departmana za unutrašnju reviziju.

Delokrug rada za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

Dužnosti i odgovornosti

Unutrašnje revizije:

- U saradnji sa nadzornikom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za vršenje revizija i drugih relevantnih usluga;
- Vršiti unutrašnje revizije, obavlja intervju sa osobljem, prima i analizira relevantnu dokumentaciju u skladu sa ciljevima CBK-a i u skladu sa Zakonom o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statutom unutrašnje revizije, Priručnikom za unutrašnje revizije, itd.;
- Vršiti redovne revizije ili revizije na zahtev, o efektivnom korišćenju resursa CBK-a, sastavlja nacрте izveštaja, diskutuje o rezultatima sa nadzornikom i unutrašnjim revizorima i sastavlja završne izveštaje o njegovom/njenom angažovanju;
- Aktivno učestvuje u diskusijama sa unutrašnjim revizorima, finalizuje dosije revizije i prati sprovođenje preporuka datih od strane unutrašnje revizije i spoljnih revizora;
- Pruža savete o pitanjima revizije, po potrebi;
- Sprovodi Zakon o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statut Unutrašnje Revizije, Priručnik Unutrašnje Revizije, Etički kodeks, Međunarodne standarde o profesionalnoj praksi unutrašnje revizije kao i sve druge akte koji regulišu delokrug unutrašnje revizije.

Sistemi/procedure i administrativna pitanja:

- Vršiti nezavisne preglede postojećih ili predloženih sistema u svim entitetima CBK-a (departmanima, odeljenjima i drugim relevantnim oblastima) predlažući i utičući na njihovo poboljšanje;
- Ocenjuje efektivnost i efikasnost svih važnih sistema unutrašnje kontrole, prati učinak, predlaže i utiče na unapređenje funkcionisanja sistema unutrašnje kontrole;
- Testira rad sistema u CBK-u, pouzdanost i potpunost informacija, kao i transakcije generisane u skladu sa zakonima, politikama, procedurama, planovima i uredbama kojima se upravlja CBK;
- Daje doprinos tokom pripreme Godišnjeg plana rada Interne revizije;
- Vršiti administrativne poslove prema potrebama direktora DUR-a, ili samog departmana.

Obuka i razvoj:

- Da ima spremnost da učestvuje u relevantnim obukama za unutrašnje revizije i da pruži odgovarajuću pomoć ostatku osoblja u Departmanu za unutrašnju reviziju;
- Da dokaže da on/ona razvija njegove/njene veštine u korist Centralne banke i Departmana za unutrašnju reviziju, unutar nje.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, računovodstva, menadžmenta ili prava;
- Najmanje pet (5) godina iskustva, od kojih tri (3) u oblasti unutrašnje revizije, ili spoljne;
- Profesionalni sertifikat iz oblasti revizije javnog/privatnog sektora;
- Odlične veštine organizacije, planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlične međuljudske i komunikacijske veštine, kao i veštine rešavanja sukoba;
- Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika govornog i pisanog (poželjan engleski jezik);
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturinom okruženju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **10. maj 2023. godine**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i punës/Pozita: Auditor i Lartë i Teknologjisë Informative
Departamenti/Divizioni: Departamenti i Auditimit të Brendshëm (Dab)
I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm
Niveli i gradës: 4

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës:

Auditori i Lartë i Teknologjisë Informative (TI) kryen auditime të teknologjisë informative, të pajtueshmërisë, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me standardet për praktikë profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe bënë vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve. Auditori i Lartë i Teknologjisë Informative punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planin e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raportet, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit dhe Teknologjisë Informative, sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e AB-së, Kodin e Etikës, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilën rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante) duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm të teknologjisë informative, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve të teknologjisë informative në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transakcionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Drejtorit të DAB-it, apo vetë departamentit.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të punonjësve në Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Departamentit të Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, shkencave kompjuterike, elektroteknike, shkencave matematiko-natyrore, apo relevante;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e Teknologjisë Informative apo në fushën e auditimit (përvoja në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Çertifikatë profesionale në fushën e Teknologjisë Informative ose auditimit të brendshëm (çertifikata në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Njohuri mbi fushat e ndryshme të teknologjisë informative si: zhvillimi i softuerit, sistemet operative, menaxhimi i data bazës, dhe rrjeta;
- Njohuri mbi kornizën dhe standardet si COBIT, ISO 27001, ITIL, etj;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 maj 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta/pozicija: Viši revizor informacione tehnologije
Departman/Divizija: Departman za unutrašnju reviziju (DUR)
Izveštava: Direktoru Departmana za unutrašnju reviziju
Nivo stepena: 4

Svrha i delokrug pozicije

Viši revizor informacione tehnologije (IT) sprovodi revizije informacione tehnologije, uskladenosti, reviziju Menadžmenta kao i preliminarno istraživanje određenih operativnih i funkcionalnih aktivnosti u skladu sa standardima za profesionalnu praksu unutrašnje revizije, kao i ocenu efikasnosti unutrašnjih kontrola ovih aktivnosti.

Viši revizor informacione tehnologije radi pod direktnim nadzorom direktora Departmana za unutrašnju reviziju CBK-a.

Delokrug rada za ovu poziciju je sledeći:

- Unutrašnje revizije;
- Sistemi i procedure i druga administrativna pitanja;
- Obuka i razvoj.

Dužnosti i odgovornosti:

Unutrašnje revizije:

- U saradnji sa nadzornikom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za vršenje revizija i drugih relevantnih usluga;
- Vršiti unutrašnje revizije, obavlja intervju sa osobljem, prima i analizira relevantnu dokumentaciju u skladu sa ciljevima CBK-a i u skladu sa Zakonom o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statutom unutrašnje revizije, Priručnikom za unutrašnje revizije, itd.;
- Vršiti redovne revizije ili revizije na zahtev, o efektivnom korišćenju resursa CBK-a, sastavlja nacrt izveštaja, diskutuje o rezultatima sa nadzornikom i unutrašnjim revizorima i sastavlja završne izveštaje o njegovom/njenom angazovanju;
- Aktivno učestvuje u diskusijama sa unutrašnjim revizorima, finalizuje dosije revizije i prati sprovođenje preporuka datih od strane unutrašnje revizije i spoljnih revizora;
- Pruža savete o pitanjima revizije i Informacione Tehnologije, po potrebi;
- Sprovodi Zakon o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statut Unutrašnje revizije, Priručnik UR-a, Etički kodeks, kao i sve druge akte koji regulišu delokrug unutrašnje revizije.

Sistemi/procedure i druga administrativna pitanja:

- Vršiti nezavisne preglede postojećih ili predloženih sistema u svim entitetima CBK-a (departmanima, odeljenjima i drugim relevantnim oblastima) predlažu i utiču na njihovo poboljšanje;
- Ocenjuje efektivnost i efikasnost svih važnih sistema unutrašnje kontrole informacione tehnologije, prati učinak, predlaže i utiče na unapređenje funkcionisanja sistema unutrašnje kontrole.;
- Testira rad sistema informacione tehnologije u CBK-u, pouzdanost i potpunost informacija, kao i transakcije generisane u skladu sa zakonima, politikama, procedurama, planovima i uredbama kojima se upravlja CBK;
- Daje doprinos tokom pripreme Godišnjeg plana rada Interne revizije;
- Vršiti administrativne poslove prema potrebama direktora DUR-a, ili samog departmana.

Obuka i razvoj:

- Da ima spremnost da učestvuje u relevantnim obukama za unutrašnju reviziju i informacionu tehnologiju, kao i da pruži odgovorajuću pomoć ostatku osoblja u Departmanu za unutrašnju reviziju;
- Da dokaže da on/ona razvija njegove/njene veštine u korist Centralne banke i Departmana za unutrašnju reviziju.

Stručna sprema/kvalifikacije

- Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije, kompjuterskih nauka, elektrotehnike, matematičko-prirodnih nauka ili relevantna;
- Najmanje pet (5) godina radnog iskustva u oblasti Informacione tehnologije ili u oblasti revizije (iskustvo u oblasti revizije Informacione tehnologije se smatra prednošću);
- Profesionalni sertifikat iz oblasti Informacione Tehnologije ili unutrašnje revizije (sertifikat iz oblasti revizije Informacione Tehnologije smatra se prednost);
- Poznavanje različitih oblasti informacione tehnologije kao što su: razvoj softvera, operativni sistemi, upravljanje bazama podataka i mreže;
- Poznavanje okvira i standarda kao što su COBIT, ISO 27001, ITIL, itd;
- Odlične veštine organizacije, planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlične međuljudske i komunikacijske veštine, kao i veštine rešavanja sukoba;
- Tačnost, pažnja na detalje i osetljivost na prioritete;
- Odlično poznavanje korišćenja softverskih aplikacija MS Office paketa;
- Tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika govornog i pisanog (poželjan engleski jezik);
- Da ima sposobnost da efikasno radi u multietničkom i multikulturinom okruženju.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo koje navodi vaše interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od strane nadležne institucije/organizacije;
- Izveštaj Trusta kojim se dokazuje vremenski period radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosova moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je **10. maj 2023. godine**.
- Apliciranje se može vršiti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhiva CBK-a. Nikakav drugi oblik apliciranja se neće uzeti u obzir.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko zvanične stranice: www.bqk-kos.org
- **Nekompletna dokumentacija se neće uzeti u obzir. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.**



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues